

Planifikimi i ndërmjetësimit të njohurive duhet gjithmonë të bëhet në bazë të parimeve dhe principeve didaktiko-metodike.

Sqarimi i terminologjisë


Pedagogjia	<u>Shkenca mbi edukimin</u>
Didaktika	<u>Shkenca mbi mësimdhënien dhe të mësuarit</u> Përse duhet të bëhet diçka? (Qëllimi i mësimit) Çka duhet bërë? (Objekti mësimor/ Tematika)
Metodika	<u>Shkenca e metodave dhe proceseve mësimore</u> Si duhet të mësohet diçka? (Metodat e mësimit) Me çka duhet të mësohet? (Mjetet mësimore)

Respektimi i këtyre varshmërive didaktiko metodike, ka një rëndësi enorme për një shkollim sistematik!


Për parapërgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e mësimit teorik dhe praktik është me rëndësi të madhe respektimi i këtyre **tetë faktorëve**:

Qëllimi i shkollimit, g rupi i shkollimit, mësimdhënësi, format e shkollimit, mjetet e shkollimit, përmbajtja e shkollimit, kushtet organizative / të jashtme, kontrollimi i suksesit

Varshmëria e ngushtë mes këtyre faktorëve do të sqarohet në tetëkëndëshin didaktik , në vijim...



Këtu duhet udhëzuar në ndikimet bilaterale të boshteve.



Keni parasysh gjithmonë përparësinë e dialektit para metodikës. Në shkollim së pari duhet të përcaktohen qëllimet e shkollimit si dhe përbajtja mësimore.

Parimet dhe shtjellimet didaktike

Për planifikim përbajtësor të mësimit praktik kemi „RREGULLA TË HEKURTA“ që mund të hasen edhe në shkrimet më të vjetra pedagogjike.

- Prej së lehtës kah e vështira
- Prej së thjeshtës kah kompleksja
- Prej së afërmes kah e largëta

si dhe,...

- Prej së përgjithshmes kah e veçanta
- Prej konkretes kah abstraktja

Keni parasysh se këto dy „rregulla të hekurta“ mund edhe të ndërrohen!

- Prej të veçantës kah e përgjithshmja
- Prej abstraktes kah konkretja



Çdo mësimdhënësi apo instruktor duhet ti ketë parasysh parimet dhe udhëzimet bazë...

Shpesh procesi mësimor ka hyrje të lehtë dhe motivuese, nëse mësimdhënësi ka parasysh parimet, në vijim.

Parimi i aktivitetit të nxënësit

- Nxitja maksimale e pavarësisë gjatë shkollimit
- Jo „shkel e shko“
- Tema me rëndësi praktike

Parimi i sigurimit të suksesit

- Sigurimi i suksesit të mëimit praktik
- Ushtrimi i teknikave të mëimit praktik, përsëritja dhe përcaktimi i të arriturave

Parimi i përshtatshmërisë rinore

- Mosha, të njihen mirë kërkesat tupore dhe mendore të të rinjëve
- Të rinjët mendojnë dhe ndiejnë ndryshe

Parimi i afërsisë praktike

- Thënia e vjetër u desh të ndërrohet:
„Ne nuk mësojmë për punëtori, por për praktikë ndërmarrëse!“
- Atë që e kanë mësuar, nxënësit duhet të jenë në gjendje ta zbatojnë në praktikë

Parimi i të vrojtuarit


- Të kuptuarit e vetëdijshëm, theksuar, qëllimshëm dhe gjithanshëm i gjësendeve, mundësisht përmes të gjitha shqisave
- Mësimdhënësi i mirë i jep rëndësi të madhe asaj që nxënësi ta njeh mirë objektin, ta vrojtojë dhe ta prekë atë.

Fjala „ e kapshme“ nënkupton, një gjësend / objekt ta kapim / prekim me dorë. Asgjë nuk është në kokë të nxënësve, çka paraprakisht nuk ka qenë në „dorë“ të nxënësit“.

Parimi i objektivitetit

- Gjthçka, çka trajtohet, në aspektin tematik duhet te jetë e saktë
- Mësimdhënësi duhet, në kuptimin e plotë të fjalës të qëndrojë mbi materien!

Ne mësojm me



Ne mbajmë mend me

